# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-468697**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Bëra gabim që qëllova me shishe”/ Delina Fico zbulon për “Shqipëria Live” se çfarë ndodhi në incidentin me protestuesit: Kishin 5 minuta që shanin |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/25/bera-gabim-qe-qellova-me-shishe-delina-fico-zbulon-per-shqiperia-live-se-cfare-ndodhi-ne-incidentin-me-protestuesit-kishin-5-minuta-qe-shanin111/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 11:56:14 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 25 shtator 2026, 11:24:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 25 shtator 2026, 11:23:00 UTC → 25 shtator 2026, 11:25:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `6665ad02779bdd931ed618866163cb1c2677df992f1399030da19ddd64dbe5de` |
| TEKSTI | `8fc3668f3fc853054f16e1f22b5c2688cf65b8ce8606b49ef8fb5d930a1d7487` |
| PAMJA | `087b3f1c81219c93e691582095ed915ca81866a79cfe3aad886c76697febc42d` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `2a4a17caa0eeed0c45c274e1d6116e28309fe1fb58c602faa41a90063b75ea7d` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `3f529bf32420afe1b21bc6d3b8138bcb5df45885bcaf02ba5967dcac0a879fe4` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/2a4a17caa0eeed0c45c274e1d6116e28309fe1fb58c602faa41a90063b75ea7d`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET KRYESORE TË FUNDIT

# "Bëra gabim që qëllova me shishe"/ Delina Fico zbulon për "Shqipëria Live" se çfarë ndodhi në incidentin me protestuesit: Kishin 5 minuta që shanin

25/09/2026 13:24



**Deputeti i Partisë Socialiste, Bledi Çuçi, ka qenë "viktima" e radhës e protestuesve në Tiranë, të cilët i kanë shkuar në kafe me thirrjet: "Burg!", "Burg!", "O hajdut".**

Ish-ministri i brendshëm ka ruajtur qetësinë duke iu kthyer vetëm me fraza: "Ik se latë nam". Ajo që ka reaguar ka qenë bashkëshortja e tij, Delina Fico që është shfaqur shumë e shqetësuar nga thirrjet. Ajo ka tentuar të qëllojë me shishe uji në drejtim të protestuesve.

Ditën e sotme, Fico ishte në një lidhje të drejtpërdrejtë me emisionin "Shqipëria Live" me Sidorela Gjonin ku tregon se çfarë ndodhi mbrëmjen e djeshme. Ajo u shpreh se nuk u përmbajt dot dhe u irritua kur protestuesit nisën të përmendnin edhe atë.

Sipas Ficos, protestuesit kishin 5 minuta që shanin para se ajo të bënte atë reagim. E pikërisht kur ajo mori shishen e ujit për t'a hedhur në drejtim të tyre, ata hapen kamerat menjëherë.

Zonja Fico dënon dhunën dhe shprehet se tani jemi në demokraci dhe mund të dalim të protestojmë për të gjitha pakënaqësitë që kemi.

**Pjesë nga intervista:**

**Delina Fico:** Ne ishim në një lokal me miqtë. Ishin disa të rinj që nxorën kamerat dhe thonin 'hajdut'. E më pas shtuan dhe gruan e aty u irritova. Nuk u përmbajta dhe i gjuajta me shishen e ujit. Bledi dhe miqtë më thanë mos i konsidero se atë vëmendje duan. Një ngjarje e trishtuar. Grupi ishte rreth moshës 20 vjeç. Ju drejtova më shumë vajzave që ishin aty dhe do kisha dëshirë ti takoja e të flisja me to, është një qëndrim i gabuar. Më lënduese ishte që grupi i të rinjve rrinte djathtas, ndërsa një burrë më i madh rrinte në të majtë dhe i dirigjonte, vetë fshihej si skuth. Gabim ata dhe gabim ndoshta unë që reagova ashtu. Ata vajza e djem nuk dinë për punën time, as për punën e partnerit tim. Është një tjetër gjë të kritikosh e të protestosh.

**Sidorela Gjoni:** A është e gjithë ngjarja ajo që pasqyrohet në video?

**Delina Fico:** Kishin 5 minuta që shanin para se unë të reagoja, kur ata e tepruan, sidomos kur më përfshinë mua. Unë bashkëjetoj me Bledi Çuçin, po nuk merrem me politikë. Ata kanë transmetuar vetëm momentin kur kam hedhur shishen e ujit.

**Sidorela Gjoni:** Çfarë mendon tani që sheh atë video?

**Delina Fico:** Më vjen shumë keq, jam e trishtuar. Pse disa të rinj i lejojnë vetes të të ofendojnë. Kanë problemet e tyre, të dalin në protestë. Unë mendoj se bëra gabim që qëllova me shishe por ndihem e fyer thellë. Nuk është hera e parë që ndodh një gjë e tillë. Kam 40 vjet punë mbi shpatulla e le të më gjykojnë për çfarë kam bërë në jetë.

## Kryesore



Anulohet tenderi 50 milionë euro për hemodializën, ministrja e re e Shëndetësisë ndalon procedurën
13:33

Plagosja me armë në Lezhë/ Kamerat e sigurisë zbardhin konfliktin, autorët u larguan me makinë, shpallen në kërkim
09:59

Moti 'përmbys' planet e pushuesve, shiu dhe era boshatisin Lungomaren në Vlorë
10:41

Përplasje për zgjedhjet në Brazil/ 31 ligjvënës amerikanë akuzojnë administratën Trump për ndërhyrje
09:47

Kuqezinjtë nisin misionin e ri në Nations League, të gjitha emocionet live dhe ekskluzivisht në DigitAlb
10:27

## Më të lexuarat

"Ku jemi katandisur!"/ Ish-deputeti Murrizi nxjerr videon e sherrit në Durrës: Ky që e rrahin si gomarin në duhan është shefi i Komisariatit Krujë

"Ke kaluar nga zyra e Ergysit që u bëre deputete?"/ Ministrja Ismaili i përgjigjet fjalës së Berishës në Kuvend: Tek Agasi isha bashkë me Argitën

"Dumani përzuri Vlorën nga zyra", Murrizi bën deklaratën e fortë në Top Story: E nxori nga qershori i 2025

Top Story/ "Kërkoi ekspertim të telefonit jashtë Shqipërisë", gazetarja Hoxha zbardh detajet nga seanca me dyer të mbyllura, çfarë deklaroi Vlora Hyseni në SPAK

"Burg, burg", një grup protestuesish përplasen me Çuçin dhe bashkëshorten në kafene, si përgjigjet deputeti i PS dhe Delina Fico

Bllokohen specat dhe açuget/ Jo vetëm perimet, Shqipëria ka probleme edhe me produktet e detit. Bllokohen në Itali

Detaje nga përplasja në rrugët e Durrësit/ Pronari i hotelit që u shemb gjatë tërmetit goditi shefin e komisariatit, si u mbyll ngjarja pa denoncim

Akuzohet për përvetësimin e 700 mijë eurove nga Posta Shqiptare, lirohet nga

Thonin Bledi Çuçi dhe gruaja hajdut, në burg. Përsëritet disa herë fjala grua dhe aty reagova. Është tepruar shumë. E di ca ishte më fyese? Fakti që hapën kamerat menjëherë, nuk e bëjnë se ju vjen nga zemra, por e bëjnë për të të filmuar sipas skenarit, të dalin në media dhe që menaxhohen nga burri që ishte aty. Manipulim i situatës.

**Sidorela Gjoni:** Çfarë komunikuat me zotin Çuçi?

**Delina Fico:** Këto që po të them ty. Pse ka ardhur puna kështu? Pse nuk jemi qytetarë që ta shprehim zemërimin tonë aty ku duhet? Jemi të gjithë qytetarë të këtij vendi. Ke pakënaqësi ndaj shtetit, dil në protestë. Janë metoda fashiste, duan të mbjellin pasiguri në vend. Ata mund të vinin të flisnin me mua dhe të më thonin jemi shumë të pakënaqur. I kemi të gjithë instrumentet të bëjmë grevë, protestë, duhet të marrë fund urrejtja. Kjo urrejtja e madhe për njerëzit e zgjedhur tani është vulgare, nuk të çon askund. Janë të manipuluar nga ai që ishte aty për të nxitur konflikte sociale.

**Sidorela Gjoni:** Përtej incidentit, cili është mendimi juaj personal për protestën?

**Delina Fico:** Protestat paqësore kanë mbështetjen time që nga dita e parë. Kam shoqëri dhe kushërinj që dalin në protestë, është e drejta e tyre. Ka patur njerëz që më kanë mbështetur, edhe ata që dalin në protestë sepse duan qytetari. Dhuna sjell dhunë. Konfliktet zgjidhen me institucionet.

**Sidorela Gjoni:** A mendoni që një person që është i zgjedhur me votë nga njerëzit duhet të kishte një reagim tjetër?

**Delina Fico:** Bledi është politikan, jo se është partneri im, është një nga figurat politike më me integritet. Nuk është hera e parë që i ndodh, nuk e meriton sulmin në kohën e tij të lirë kur është me familjen. Siç nuk dua që Bledi të flasë në emrin tim, as unë nuk mund të flas në emrin e tij.

**Sidorela Gjoni:** A ju vjen keq që iu linçojnë?

**Delina Fico:** Shumë keq më vjen, e kam thënë disa herë, jam një grua, bashkëjetoj me Bledin, kam punën time. Jam kundër dhunës ndaj çdo politikani, gazetari apo aktivisti. Është vijë e kuqe në jetën time dhuna.

**Top Channel**

burgu ish-drejtoresha, Elisabeta Mataj

**Top Story/ "Mbrojtja do jetë arrogante", Vangjeli për deklaratën e Vlora Hysenit: Po shantazhon njerëzit me pushtet. Pretendimi i saj për Agasin, i gënjeshtërt**

**Top Story/ "Hakmarrja është intimidimi i Klodiana Lalës", Murrizi për Vlora Hysenin: Ajo e di kush ka hyrë e kush ka dalë nga zyra e Agasit**

## Aktualitet »




**Zjarr në një banesë në Sarandë, çifti i të moshuarve përfundon në spital**

25/09 13:36



**Sherr me sende të forta në Elbasan/ Arrestohen 4 persona, mes tyre dy vëllezër**

25/09 13:34




**Sherr me shkopinj bejsbolli mes të miturve në Yzberisht, policia parandalon përplasjen dhe procedon penalisht 23 persona**

25/09 13:29



**Detaje nga përplasja në rrugët e Durrësit/ Pronari i hotelit që u shemb gjatë tërmetit goditi shefin e komisariatit, si u mbyll ngjarja pa denoncim**

25/09 13:14



**Shiu nuk do zgjasë! Fundjava me diell dhe temperatura vjeshte deri në 27-28 gradë celsius**

25/09 12:33



**"Të vijojë lufta ndaj korrupsionit"/ Nga komandant i NATO-s në ambasador në Tiranë. Media në SHBA: Si e gjen Eric Wendt Shqipërinë**

25/09 12:32

## Kryesore »








Këshilli Bashkiak kërkon pjesëmarrjen e Veliajt në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, kërkesë SPAK-ut dhe Burgjeve
25/09 13:45

Zjarr i madh në një traget pranë Mykonos, evakuohen 29 persona/ Flakët nisën nga një kamion
25/09 13:39

Anulohet tenderi 50 milionë euro për hemodializën, ministrja e re e Shëndetësisë ndalon procedurën
25/09 13:33




Sherr me shkopinj bejsbolli mes të miturve në Yzberisht, policia parandalon përplasjen dhe procedon penalisht 23 persona
25/09 13:29



Alarm në detin Egje/ Përfshihet nga zjarri një traget, evakuohen 29 persona
25/09 13:18



Detaje nga përplasja në rrugët e Durrësit/ Pronari i hotelit që u shemb gjatë tërmetit goditi shefin e komisariatit, si u mbyll ngjarja pa denoncim
25/09 13:14

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



Top Channel/ Ambasadori i Bullgarisë në Pustec, Ivajlo Kiro:E drejtë që njerëzit të protestojnë



Top News – Trump i jep Ukrainës Patriotët / Zelenski konfirmon: Ka marrë vendimin përfundimtar



Top News – 'Largohuni frikacakë'. Izraeli mban shënim shtetet që e bojkotuan në OKB




Top News – Trump i dëbon, Papa i afron: 'Të gjithë gazetarët janë të mirëpritur'



Top News – Rendi i ri botëror i Erdoganit / Turqia nuk do zgjedhë mes lindjes dhe perëndimit




Top News- Si u vra heroi Afrim Bunjaku / Dalin pamjet e nisjes së sulmit të serbëve në Banjskë



© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.